



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
*Qeveria –Vlada-Government*

*Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe Teknologjisë- Ministarstva za Obrazovanje Nauku  
i Tehnologiju-Ministry of Education Science & Technology*

Kabineti i Ministrit/Kabinet Ministra/ Cabinet of the Minister

**UDHËZIM ADMINISTRATIV**

**Kriteret dhe procedurat për akreditimin e shkollave të larta profesionale dhe shkollave të larta teknike në Republikën e Kosovës**

**NUMËR:** 12/ 2009

**DATË:** 05.06. 2009

Në mbështetje të nenit 93 (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të neneve 4, 11, 23,3 të Ligjit mbi Arsimin e Lartë në Kosovë (LAL; 2002/3), nenet 2, 5, 6 dhe 10 dhe 14,2 të Ligjit për Kualifikimet Kombëtare (LKK; 2008/060), dhe nenit 25, paragrafi 7 të Rregullores së Punës të Qeverisë së Kosovës nr. 1/2007, Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë (MASHT) nxjerr këtë Udhëzim administrativ:

**Neni 1**  
**Qëllimi**

- 1 .Ky Udhëzim administrativ përcakton parimet e përgjithshme, përgjegjësitë dhe procedurat që duhet të respektohen për akreditimin e shkollave të larta profesionale dhe shkollave të larta teknike në kuadër të Republikës së Kosovës.

**Neni 2**  
**Terminologjia**

1. Termet e përdorura në këtë Udhëzim administrativ janë të përcaktuara në Shtojcën A.

### **Neni 3**

#### **Kërkesat e përgjithshme**

1. Programet e larta profesionale në nivelin e arsimit post-sekondar të lartë (d.m.th. në nivelin 5 EQF/NQF e më lartë (European Qualification Framework – Korniza Evropiane e Kualifikimeve-KEK, National Qualification Framework – Korniza Kombëtare e Kualifikimeve-KKK) mund të ofrohen nga ofruesit (institucionet) publik/e ose privat/e të arsimit dhe aftësimit profesional, të akredituara nga AKA dhe të licencuara nga MASHT, si shkolla të larta profesionale ose si shkolla të larta teknike.
2. Kur një institucion përmbush kushtet e nivelit 6 EQF/NQF ose më lartë, mund të aplikojë për t’u licencuar si shkollë e lartë profesionale. Atëherë kur institucioni përmbush kushtet e EQF/NQF niveli 5, atëherë aplikon për t’u licencuar si shkollë e lartë teknike. Shkolla e lartë profesionale, po ashtu mund të ofrojë në nivelet 4 dhe 5 EQF/NQF. Shkolla e lartë teknike gjithashtu mund të bëjë ofrimin në nivelin 4 EQF/NQF. Niveli 4 duhet të jetë i projektuar për të siguruar një rrugë drejt nivelit më të lartë të kualifikimit për ata studentë (zakonisht në moshë më të vjetër), të cilët mund të demonstrojnë praktikë brenda fushës së kompetencave profesionale, por të cilët nuk posedojnë një kualifikim formal të nivelit 4.
3. Një institucion që ofron vetëm nivelin 4 nuk mund të aplikojë për t’u akredituar si një shkollë e lartë profesionale apo shkollë e lartë teknike.
4. Asnjë shkollë e lartë profesionale ose shkollë e lartë teknike nuk mund të ofrojë grada profesionale. Vetëm institucionet e shkencave të aplikuara mund të ofrojnë grada profesionale, siç është përcaktuar në nenin 12 të Udhëzimit administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Kosovë.

### **Neni 4**

#### **Akreditimi nga AKA**

1. Të gjitha institucionet publike dhe private të arsimit të lartë profesional në Kosovë, programet e studimit të të cilëve çojnë në arritjen e një diplome profesionale në nivelin 5 EQF/NQF, ose më të lartë mund të jenë kandidatë për akreditimin nga AKA. Ato mund të jenë:
  - 1.1. Institucionet aktive publike ose private të arsimit profesional dhe teknik të nivelit jouniversitar;
  - 1.2. Një institucion i ri arsimor që aspirojnë të ofrojë programe studimi në sektorin privat të arsimit profesional;
  - 1.3. Një institucion i akredituar i arsimit profesional i cili aspirojnë të ofrojë programe të reja studimi;
  - 1.4. Një institucion i akredituar i arsimit profesional i cili dëshiron ta zgjas periudhën e akreditimit – d.m.th. që kërkon riakreditim.

2. Akreditimi mund të bëhet në nivel të:
  - 2.1 Institucionit;
  - 2.2 Programit të studimit;
  - 2.3 Institucionit dhe programit të studimit.
3. Ofruesi i arsimit të lartë apo arsimit profesional që aplikon për akreditim si shkollë e lartë profesionale ose si një shkollë e lartë teknike, duhet të paraqesë një kërkesë në AKA të paktën një vit para datës kur procesi i akreditimit pritet të fillojë.
4. Atëherë kur aplikimi është për një program studimi në nivelin 5 apo më lartë të EQF/NQF, AKA do të jetë kompetent për të miratuar kualifikimin në të cilën shpie/çon programi i ofruar, në pritje të themelimit të plotë të Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve të Kosovës (AKK). Më pas, ajo do të ushtrojë këtë miratim në përputhshmëri me AKK. Me miratimin e një kualifikimi në EQF/NQF në nivelin 5 ose më lartë, AKA do të aplikojë filozofinë, kriteret dhe standardet e përcaktuara në kuadër të Kornizës Evropiane të Kualifikimeve.

## **Neni 5**

### **Standardet e Akreditimit**

1. Akreditimi është një procedurë zyrtare dhe transparente e vlerësimit të cilësisë, gjatë së cilës një organ i pavarur përdor standarde ndërkombëtarisht të krahasueshme në mënyrë që të vlerësojë nëse institucionet e arsimit të lartë dhe atij profesional dhe programet e tyre të studimit i përmbushin kërkesat e paracaktuara minimale të cilësisë.
2. Standardet shërbejnë si pikë referimi dhe vendimi për akreditim, dhe akreditimi bazohet në ato standarde.

## **Neni 6**

### **Akreditimi institucional: Standardet e cilësisë të institucioneve të larta arsimore profesionale që aplikojnë për akreditim si shkollë e lartë profesionale ose si shkollë e lartë teknike**

1. Në momentin e paraqitjes së kërkesës për akreditim, institucioni duhet të sigurojë dokumentacionin dhe të dhënat për fushat e mëposhtme:
  - 1.1 Fusha e vlerësimit: Misioni, strategjia, organizimi dhe menaxhimi i cilësisë në institucion.
    - 1.1.1 Institucioni duhet të demonstrojë se është organ institucional i themeluar me ligj, që vepron në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret relevante në Kosovë.
    - 1.1.2. Institucioni duhet të posedojë një deklaratë publike të misionit. Kjo deklaratë duhet t'i përfshijë praktikrat dhe objektivat më të mira profesionale dhe kërkimore dhe të bëjë të qartë kontributin e institucionit për ekonominë dhe shoqërinë kosovare.

- 1.1.3.** Institucioni duhet të ketë një plan strategjik për zhvillimin e tij për një periudhë minimum trevjeçare.
  - 1.1.4.** Procedurat për vendimmarrje, kompetencat dhe përgjegjësitë në kuadër të institucionit duhet të jenë të përcaktuara dhe të jenë në dispozicion të personelit dhe studentit.
  - 1.1.5.** Institucioni duhet të demonstrojë se zotëron burime të mjaftueshme njerëzore, materiale dhe financiare, si dhe infrastrukturën fizike dhe teknike për të bërë të mundur realizimin e qëllimeve dhe objektivave të përcaktuara në Planin Strategjik. Institucioni duhet të ndërmarrë veprimet e duhura për të vënë në dispozicion siç duhet llogaritë vjetore të auditimit dhe pasqyrat financiare me kërkesë të AKA.
  - 1.1.6.** Burimet financiare të institucionit duhet të jenë transparente dhe nuk duhet të kufizojnë autonominë e saj akademike.
  - 1.1.7** Institucioni duhet të posedojë një sistem të brendshëm të sigurimit të cilësisë të cilat mund të veprojnë për të demonstruar se funksionon në mënyrë të plotë.
- 1.2.** Fusha e vlerësimit: Programet profesionale të studimit
- 1.2.1** Për të qenë e akredituar si shkollë e lartë profesionale, institucioni duhet të ofrojë një ose më shumë programe studimi të cilat çojnë në dhënien e një Diplome (niveli 6 i EQF/NQF) së paku në një fushë profesionale. Një institucion i cili nuk ofron Diploma profesionale, nuk mund të aplikojë për akreditim si shkollë e lartë profesionale. Nëse institucioni ofron një apo më shumë programe të studimit të cilat shpjen në dhënien e certifikatës profesionale (niveli 5 i EQF/NQF) së paku në një fushë profesionale duhet të aplikojë për akreditim si shkollë e lartë teknike.
  - 1.2.2** Përmbajtja e planprogramit e një Certificate apo Diplome profesionale duhet të bazohet në praktikat më të mira profesionale në këtë fushë dhe duhet të çojë në një mundësi të punësimit po në këtë fushë. Institucioni duhet të jetë në gjendje të demonstrojë (si pjesë e kërkesës për akreditimin e tij), se ka marrëveshje me bazë të fortë dhe se konsultohet rregullisht me praktikuesit brenda fushës profesionale. Aranzhimet e tilla mund të marrin formën e paneleve konsultative të nxjerra nga praktikuesit në këtë fushë brenda dhe jashtë Kosovës, përfshirjen aktive të praktikuesit në procesin e zhvillimit të planprogrameve dhe vlerësimin e studentëve dhe angazhimin aktiv të personelit mësimdhënës në këtë fushë profesionale, përmes praktikave të tyre ose nëpërmjet hulumtimit të tyre.
  - 1.2.3** Programi duhet të specifikohet në aspektin e objektivave të të mësuarit, të trajtohen kompetencat dhe njohuritë profesionale, rezultatet e parapara të mësimit, metodat e vlerësimit dhe të tregojnë qartë vlerën, nivelin e koeficientit të kreditit për secilin komponent të njësisë apo modulit. Roli dhe koeficienti i kreditit të ndonjë njësie praktike profesionale apo moduli duhet të jetë i identifikuar qartë.

- 1.2.4 Objektivat e programit duhet të korrespondojnë me misionin dhe planin strategjik të institucionit.
  - 1.2.5 Të gjitha programet duhet të hyjnë në Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve në nivelin 5 ose 6 EQF/NQF (shih Shtojcën A).
  - 1.2.6 Një diplomë profesionale apo gradë do të konsiderohet kualifikim normal pas përfundimit të suksesshëm të një programi në nivelin 6 EQF/NQF. Një certifikatë profesionale do të konsiderohet kualifikim normal pas përfundimit të suksesshëm të një programi në nivelin 5 EQF/NQF.
  - 1.2.7 Atëherë kur është e paraparë që mësimi paraprak mund të jetë i pranuar për arritjen e kualifikimit, rregulloret duhet të përcaktojnë qartë mënyrën se në të cilat raste të mësimi paraprak ato mund të vlerësohen dhe të specifikohet maksimumi i krediteve të cilat mund të jepen në raste të tilla.
- 1.3 Fusha e vlerësimit: Mësimdhënia dhe Mësimnxënia**
- 1.3.1 Të mësuarit, mbikëqyrja gjatë punës dhe metodat e vlerësimit duhet të jenë në pajtueshmëri me qëllimet dhe objektivat e deklaruara të programeve të studimit.
  - 1.3.2 Kriteret, rregullat dhe procedurat për vlerësimin e studentëve duhet të publikohen dhe të përdoren në vazhdimësi.
  - 1.3.3 Procedurat për monitorimin e përparimit të studentëve dhe rregulloreve që qeverisin dhënien e diplomave dhe certifikatave profesionale, duhet të jenë të specifikuar dhe institucioni duhet të tregojë se si e monitoron arritjen dhe progresin.
  - 1.3.4 Institucioni përdor të dhëna periodike të mbledhura nga të diplomuarit (alumini) e tij.
- 1.4 Fusha e vlerësimit: Kërkimet/hulumtimet e aplikuar dhe praktikat profesionale**
- 1.4.1 Kërkimi/hulumtimi i aplikuar dhe praktika profesionale duhet të jenë pjesë e aktiviteteve të institucionit.
  - 1.4.2 Aplikimi i praktikës së tillë profesionale hulumtuese duhet të jetë në përputhje me planin strategjik dhe këto aktivitete duhet të përmbushin standardet ndërkombëtare kudo që është e mundur.
  - 1.4.3 Institucioni duhet të demonstrojë se si t'i aplikojë hulumtimet dhe praktikat e aktiviteteve profesionale (në secilën fushë) të cilat do të përdoren për të mbështetur programet e studimit.
  - 1.4.4 Institucioni duhet të paraqesë provat e projekteve ekzistuese dhe bashkëpunuese me ndërmarrjet qeveritare, komerciale dhe jofitimprurëse.
- 1.5 Fusha e vlerësimit: Mësimdhënia dhe vlerësimi i personelit**
- 1.5.1 Procedurat për zgjedhjen, emërimin dhe promovimin e të mësuarit dhe vlerësimin e stafit duhet të jenë themeluar dhe publikuar. Stafi mësimdhënës duhet të ketë kualifikim akademik në fushën profesionale në të cilën ata japin mësim. Shkathtësitë mësimdhënëse dhe arritjet e hulumtimit të aplikuar duhet të përfshihen në regjistrin institucional të stafit.
  - 1.5.2 Atëherë kur institucioni propozon të jep titullin Profesor, kriteret përmes të

cilave jepet ky titull duhet të miratohen nga AKA.

**1.5.3** Institucioni duhet të lehtësojë arsimimin e vazhdueshëm profesional dhe zhvillimin e stafit të vet, duke përfshirë edhe shkathtësitë e të mësuarit e tyre dhe aftësitë momentale të tyre për fushën profesionale.

**1.5.4** Institucioni duhet të ketë politika afatgjate për motivim/nxitje të vazhdueshme të mësimdhënies dhe vlerësimin e stafit. Institucioni duhet të garantojë se ata do të vlerësohen nga kolegët e tyre/ekspertët përkatës dhe se këshillat për të ardhmen e tyre për zhvillimin e karrierës do të jetë në dispozicion të tyre.

**1.6** Fusha e vlerësimit: Stafi administrativ dhe teknik

**1.6.1** Procedurat për emërimin dhe avancimin e personelit administrativ duhet të jenë të rregulluara dhe të publikuara.

**1.6.2** Institucioni duhet të sigurojë se ofron zhvillim dhe arsim profesional të vazhdueshëm për stafin administrativ dhe teknik.

**1.7** Fusha e vlerësimit: Organizimi i brendshëm dhe sigurimi i cilësisë

**1.7.1** Proceset e vendimmarrjes, ngritja e kompetencave dhe përgjegjësi për të gjitha palët e përfshira duhet të jenë të rregulluara dhe të publikuara.

**1.7.2** Mësimdhënia, stafi vlerësues dhe studentët duhet të jenë të përfshirë në marrjen e vendimeve për ato procese që ndikojnë në edukim dhe mësimdhënie.

**1.7.3** Procedurat e sigurimit të cilësisë për vlerësimin e programit duhet të jenë të përgatitura. Institucioni duhet të përdor rezultatet e vlerësimit të programit të tyre në rishikimin/shqyrtimin periodik të programeve të studimit.

**1.8** Fusha e vlerësimit: Studentët

**1.8.1** Kriteret dhe procedurat për regjistrimin e studentëve dhe diplomimin e tyre duhet të jenë të përcaktuara qartë dhe të publikuara në programet e tyre të studimit.

**1.8.2** Institucioni duhet të monitorojë progresin dhe arritjet e studentëve gjatë tërë kohës së studimeve të tyre.

**1.8.3** Barazia gjinore, personat me aftësi të kufizuara, barazia fetare dhe etnike në institucion duhet të jetë e garantuar.

**1.8.4** Raporti midis mësimdhënies, stafit vlerësues dhe studentëve duhet të jetë i tillë që të garantojë se synimet arsimore dhe objektivat institucionale janë të arritshme.

**1.8.5** Institucioni duhet të garantojë që studentët potencial dhe aktual të kenë qasje në informata dhe shërbime këshilluese gjatë studimeve të tyre. Institucioni duhet të ketë procedura që u mundësojnë studentëve për të vlerësuar përparimin e tyre gjatë studimit.

**1.9** Fusha e vlerësimit: Infrastruktura

**1.9.1** Institucioni duhet të zotërojë një infrastrukturë adekuate teknike dhe fizike për të bërë të mundur arritjen e objektivave të saj afatgjate.

- 1.9.2** Institucioni duhet të jetë në gjendje të demonstrojë fuqinë e lidhjes së tij me praktikuesit në fushën(at) profesionale në të cilën/at, institucioni i ofron programet e studimit.
- 1.10** Fusha e vlerësimit: Bashkëpunimi
- 1.10.1** Institucioni duhet të jetë pjesë aktive e zbatimit të qëllimeve të procesit të Bolonjës.
- 1.10.2** Institucioni duhet të krijojë marrëdhënie të suksesshme në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Ai duhet të nxisë bashkëpunimin me institucionet tjera të arsimit, me partnerët social dhe veçanërisht mjedisin përkatës të punës dhe të grupeve të interesit brenda shoqërisë kosovare.
- 1.10.3** Institucioni duhet të marrë pjesë në programet kombëtare dhe ndërkombëtare për shkëmbimin e studentëve dhe stafit.

## **Neni 7**

### **Akreditimi i programeve: Standardet e cilësisë për programet e studimit në institucionet e akredituara të shkollave të larta profesionale apo shkollave të larta teknike**

- 1** Çështjet të cilat duhet të vlerësohen gjatë akreditimit të një programi të studimit janë:
- 1.1** Fusha e vlerësimit: Zbatimi i programit dhe objektivat e mësimdhënies
- 1.1.1** Objektivat e programit duhet të korrespondojnë me misionin e institucionit dhe planin strategjik të tij.
- 1.1.2** Programi duhet të përfshijë në mënyrë të qartë rezultate të identifikueshme të të mësuarit të cilat janë objekt i sigurimit të cilësisë dhe duhet të dokumentohen në mënyrë të tillë që të bëjë të mundur që këto rezultate të vlerësohen kundër propozimit të nivelin EQF/NQF dhe vlerës së kreditit. Këto duhet të specifikohen në atë mënyrë që e lejon AKA të aprovojë kualifikimin apo titullin e dhënë pas përfundimit të programit të studimit.
- 1.1.3** Metodatat e mësimit dhe vlerësimit duhet të përputhen plotësisht me qëllimet dhe objektivat e deklaruara në programin e studimit.
- 1.1.4** Kriteret, rregulloret dhe procedurat për vlerësimin e studentëve duhet të publikohen dhe përdoren në vazhdimësi.
- 1.1.5** Puna praktike apo strukturimet dhe vlerësimet tjera të punës duhet të jenë pjesë përbërëse e programit për një thirrje profesionale. Koha dhe vendi i mbajtjes së punës praktike duhet të jetë e specifikuar në mënyrë të qartë.
- 1.1.6** Qëllimet arsimore të mbajtjes së punës praktike apo përvojës së punës së strukturuar duhet të përcaktohen dhe kushdo që është i përfshirë në institucion ose në vendin e punës duhet të ketë njohuri për to.

**1.1.7** Procedurat për zgjedhjen, kualifikimin, tutorimin dhe vlerësimin e mbajtjes së punës praktike apo përvojës tjetër të punës duhet të jenë të përcaktuara qartë.

**1.2** Fusha e vlerësimit: Stafi mësimdhënës i ndërlidhur me programin

**1.2.1** Ky program duhet të drejtohet nga mësimdhënësit dhe vlerësuesit kompetent me kualifikime profesionale dhe arsimore përkatëse në fushën e praktikës profesionale për të cilat studentët janë duke u përgatitur. Mësimdhënësia dhe stafi vlerësues duhet të caktohet në mënyrë transparente dhe me procedura konkurruese nga një komision me autoritet në një institucion të akredituar.

**1.2.2** Stafi i përhershëm duhet të mbulojë së paku 50% të të gjithë ngarkesës së mësimdhënies dhe vlerësimit të një programi të studimit dhe të jetë profesionalisht i kualifikuar. Praktikuesit profesionalisht të kualifikuar duhet të formojnë bilancin e mësimdhënies dhe të ekipit të vlerësimit.

**1.2.3** Mësimdhënësia dhe vlerësimi mund të bëhen brenda institucionit, në vendet e trajnimit ose në situata tjera të punës profesionale. Kontratat e stafit duhet të lejojnë institucionin për të ndihmuar/lehtësuar këtë. Institucioni duhet të marrë përgjegjësi të qarta për të siguruar që shëndeti dhe siguria e personelit të tij, kur kërkohet për të punuar larg institucionit, është e mbrojtur.

**1.3** Fusha e vlerësimit: Studentët

**1.3.1** Kriteret për regjistrim të studentëve në institucion duhet të publikohen.

**1.3.2** Studentët duhet të marrin pjesë në një program informimi në fillim të çdo faze të programit. Ky program informimi duhet të përfshijë një seancë për sjelljen etike, shëndetësinë dhe për punë të sigurt në çdo vendosje profesionale ose situata tjera të punës.

**1.3.3** Mobiliteti/lëvizshmëria arsimore e studentëve duhet të mbështeten dhe të promovohen vazhdimisht nëpërmjet njohjes së kredive reciproke midis institucioneve dhe programeve të një natyre të ngjashme.

**1.3.4** Institucioni duhet të marrë masa për të siguruar që studentët janë të mbështetur dhe të këshilluar vazhdimisht gjatë të mësuarit e tyre.

**1.4** Fusha e vlerësimit: Pajisjet dhe infrastruktura

**1.4.1** Programi duhet të posedojë burime/resurse të mjaftueshme për të përmbushur objektivat e tij. Këto resurse duhet të sigurohen për një periudhë të paktën 3 vjeçare.

**1.4.2** Kur këto burime janë ofruar nga një partner profesional, atëherë institucioni duhet të sigurojë se ekziston një bazë kontraktuese që rregullon këtë marrëdhënie. Në këtë kontekst, burimet e disponueshme përfshijnë ato brenda vendit të punës. Të gjitha këto kontrata duhet të korrespondojnë me ligjin aktual të punës dhe atë social si dhe rregulloret përkatëse.

**1.4.3** Programi pranon rregullisht mjetet financiare të nevojshme në mënyrë që të sigurohet se do të arrijë objektivat arsimore dhe pajisjet e nevojshme në lidhje me burimet njerëzore, dhomat dhe burimet fizike.



## **1.5 Fusha e vlerësimit: Fushë veprimtaria profesionale**

- 1.5.1** Institucioni duhet të paraqesë shifrat makroekonomike (zhvillimin ekonomik, punësimin sektorial dhe shkallën e papunësisë) të industrive relevante ndaj programit të ofruar si dhe vlerësimin e mundësive të punësimit dhe arsimit për të diplomuarit e saj.
- 1.5.2** Industritë kryesore dhe llojet e ndërmarrjeve dhe të organizatave duhet të emërohen aty ku mund të gjejnë punë të diplomuarit.
- 1.5.3** Duhet të specifikohen shkathtësitë e kërkuara për përmbushjen e detyrave dhe të punëve profesionale edhe në nivelet më të larta profesionale.

### **Neni 8**

#### **Procedura standarde për akreditim përfshin katër faza:**

- 1.** Faza e parë: Vlerësimi/vetëvlerësimi i brendshëm nga institucioni dhe hartimi i raportit vetëvlerësues.
- 2.** Faza Dy: Vlerësimi i jashtëm nga një grup i pavarur i ekspertëve dhe raporti i vlerësimit, së bashku me rekomandime për përmirësim dhe një rekomandimi të përgjithshëm për Këshillin Kombëtar të Cilësisë (KKC) të AKA. (I njëjti ekip i ekspertëve mund të shfrytëzohet për të vlerësuar programet e ngjashme në institucione të ndryshme).
- 3.** Faza e tretë: Vendimi për Akreditim nga ana e Këshillit Kombëtar të Cilësisë të AKA dhe miratimi i atij vendimi nga ana e Ministrit të Arsimit.
- 4.** Faza e katërt: Vazhdimësia e procedurës për përmirësimin e cilësisë në institucionin e vlerësuar dhe dakordimi i një plan veprimi duke marrë parasysh rekomandimet e raportit të vlerësimit të jashtëm.

### **Neni 9**

#### **Aplikimi për akreditim**

- 1.** Kërkesa për akreditim duhet të paraqitet në Agjencinë Kosovare të Akreditimit.
- 2.** Dorëzimi i aplikimit nga një institucion publik i arsimit të lartë profesional mund të bëhet nga:
  - 2.1** Një organ përgjegjës për shkollat profesionale dhe teknike publike (nëse është e aplikueshme);
  - 2.2** Menaxhmenti i institucionit;
  - 2.3** Qeveria (MASHT).
- 3.** Kërkesa për akreditim mund të paraqitet/dorëzohet në nivel të:
  - 3.1** Institucionit;
  - 3.2** Programit të studimit;
  - 3.3** Institucionit dhe programit të studimit.
- 4** Kërkesa për akreditim mund të dorëzohen në çdo kohë në AKA.

5. Kërkesa duhet të vendoset në mënyrë të tillë që të demonstrojë se institucioni ose programi i plotëson kriteret e përcaktuara në nenet 6 dhe 7 të këtij Udhëzimi.
6. Kërkesa për akreditimin e një institucioni privat i nënshtrohet një vlerësimi paraprak i cili dëshmon se ai i plotëson kërkesat e përgjithshme të akreditimit sipas kritereve të caktuara nga AKA. Këto janë të përcaktuara në nenin 6 të këtij Udhëzimi administrativ.
7. Kërkesa për akreditim e paraqitur nga institucioni duhet kontrolluar nga stafi i AKA për tu siguruar se janë përfshirë të gjitha dokumentet e nevojshme dhe për tu përcjellë te Këshillit Kombëtar i Cilësisë i AKA për shqyrtim. Nëse është e nevojshme, AKA do të mbajë lidhje me KKC për të siguruar harmonizimin e niveleve të studimit.
8. Nëse KKC dhe AKA konsiderojnë se dokumentacioni i nevojshëm është siguruar, atëherë vlerësimi i institucionit do të përfshihet në planin vjetor të punës në AKA.
9. AKA, brenda tre muajve nga marrja e kërkesës, do të njoftojë institucionin për fillimin e procesit të akreditimit dhe afatet kohore.
10. Institucioni aplikues për akreditim është i detyruar t'i nënshtrohet procesit të vetëvlerësimit.
11. Institucioni konsultohet nga AKA për periudhën e vetëvlerësimit dhe dorëzimit të raportit të vetëvlerësimit.
12. Raporti i vetëvlerësimit do të jetë i shkurtër dhe përmbledhës dhe duhet të jetë analitik, kritik dhe i bazuar në dëshmi të veprimtarive në institucion.
13. Raporti i vetëvlerësimit dhe dokumentacioni mbështetës duhet të paraqitet në AKA së paku një muaj para se të organizohet vizita e ekipit të ekspertëve të pavarur në institucion.
14. Stafi i AKA do të shkruajë një raport mbi vlerësimin paraprak. Ky raport do të aprovohet nga njëri anëtar i KKC.
15. Kur vlerësimi paraprak është i suksesshëm, AKA vazhdon me fazën e 2- të të procedurës së akreditimit. Nëse raporti vjen në përfundim negativ, atëherë aplikimi do të refuzohet.
16. Institucioni mund të ankohet kundër vendimit të AKA në bazë të nenit 21 të këtij Udhëzimi administrativ.

## **Neni 10**

### **Përzgjedhja e ekspertëve**

1. Procesi i përzgjedhjes së ekspertëve fillon menjëherë pasi që AKA dhe institucioni aplikues merren vesh për fillimin e procedurave të akreditimit.
2. Këshilli Kombëtar i Cilësisë bën emërimin e ekipit të ekspertëve.
3. Institucioni aplikues ka të drejtë të bëjë vërejtje lidhur me emërimin e ndonjë eksperti.
4. Nëse AKA pajtohet se vërejtja është e arsyeshme, siç është animi i mundshëm, ajo do të caktojë një ekspert tjetër.

5. Ekspertët nënshkruajnë deklaratë nën betim se do të kryejnë obligimet e tyre në harmoni me standardet dhe udhëzimet evropiane për sigurimin e cilësisë dhe me paanshmëri. Ekspertët janë të betuar në besueshmëri: ata nuk do ta kalojnë asnjë informacion nga procedura te pala e tretë.

### **Neni 11**

#### **Përbërja e ekipit të ekspertëve**

1. Ekipi i vlerësimit të jashtëm përbëhet prej 2-6 ekspertë të pavarur, varësisht nga madhësia e institucionit që vlerësohet.
2. Ekspertët janë të klasifikuar sipas fushave të caktuara të arsimit dhe duhet të kenë përvojë në proceset e vlerësimit të cilësisë dhe akreditimit.
3. Anëtarët e ekipit vlerësues duhet t'i plotësojnë këto kritere:
  - 3.1 Kualifikim adekuat të nivelit të lartë dhe njohuri të mësimdhënies universitare në fushën e caktuar;
  - 3.2 Hulumtim në fushën e caktuar dhe njohuri mbi aktivitetet hulumtuese universitare;
  - 3.3 Përvojë në menaxhimin e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë brenda universitetit, ose organizata profesionale të ngjashme.;
  - 3.4 Përvojë me strukturat administrative dhe organizative të universitetit dhe njohuri në sistemet e menaxhimit;
  - 3.5 Përvojë në mësimdhënie dhe përvojë në zhvillimin, implementimin dhe vlerësimin e planprogrameve;
  - 3.6 Të jenë të pavarur nga institucioni që vlerësohet dhe të mos ketë konflikt interesi.

### **Neni 12**

#### **Detyrat e ekspertëve**

- 1 AKA nënshkruan kontrata ligjore me ekspertët e emëruar.
2. Vlerësimi i jashtëm përfshin një vizitë në institucion për t'i verifikuar informatat në raportin e vetëvlerësimit.
3. Detyrë kryesore e ekspertëve është vizita në institucionin që vlerësohet dhe hartimi i raportit të vlerësimit.
4. Në rast se ekipi i ekspertëve nuk mund të mbulojë/përfshijë gjithçka gjatë vizitës në një institucion, ata mund të bëjnë vlerësimin në bazë të raportit të vetëvlerësimit.

### **Neni 13**

#### **Vizita e ekipit të ekspertëve**

1. Vizitat në institucion duhet të strukturohen ashtu që të mund t'i plotësojnë kërkesat specifike të procedurës (akreditimi institucional, akreditimi i programeve ose riakreditimi) dhe të koordinohen me institucionin.
2. Si parapërgatitje, ekspertët duhet t'i marrin të gjitha dokumentet e aplikimit si dhe të

- gjitha informacionet e nevojshme për vizitë në institucion (udhëzimet për ekspertë, kodi i praktikës së mirë për vizitat në terren, kriteret bazë, etj.) së paku katër javë para vizitës në institucion.
3. Së paku 4 javë para vizitës, ekspertët marrin raportin e vetëvlerësimit, i cili përmban fakte që duhet verifikuar gjatë vizitës në institucionin aplikues.
  4. Vizita në institucion zgjat së paku dy ditë.
  5. Gjatë vizitës ekspertët bisedojnë me grupe të ndryshme individësh që kanë role të ndryshme në institucionin që vlerësohet. Ata mund ta vëzhgojnë mësimin, vlerësimin dhe stafin administrativ, studentët, këshilltarët profesional dhe organin qeverisës të institucionit për çështjet përkatëse. Ata po ashtu mund të kërkojnë që të shohin modelin e testit të provimit dhe punën e vlerësuar të studentit. Ata mund të vizitojnë edhe vendin e punës.
  6. Gjatë vizitës në institucion, grupi i ekspertëve përcillet nga eksperti i AKA për vlerësim dhe akreditim, i cili e ka rolin e koordinuesit të procesit.
  7. Njëri prej anëtarëve të grupit të ekspertëve caktohet drejtues i grupit dhe është përgjegjës për mbikëqyrjen e hartimit të raportit të vlerësimit.

#### **Neni 14** **Raporti i vlerësimit**

1. Grupi i ekspertëve harton raportin e vlerësimit në bazë të fakteve të mbledhura gjatë vizitës në institucion dhe përmbajtjes së raportit të vetëvlerësimit dhe dokumenteve përcjellëse. Puna e ekipit do të jetë në harmoni me Udhëzimet për ekspertë të caktuara nga AKA.
2. Raporti duhet të përfundojë me një rekomandim për akreditim ose joakreditim të institucionit që vlerësohet si dhe me rekomandime për përmirësim të cilësisë dhe standardeve në atë institucion.
3. Raporti duhet të bazohet në konsensusin e ekipit të ekspertëve. Në rastet kur nuk mund të arrihet një konsensus, raporti duhet të plotësohet me një deklaratë shtesë.
4. AKA i dërgon institucionit draftin e raportit të vlerësimit. Institucioni ka të drejtë të paraqesë një koment me shkrim për raportin e ekspertëve. Ky koment mund të përfshijë informacione faktike të përmbledhura në raport, por jo edhe në rekomandimet e bëra. Komentet duhet të dorëzohen në AKA brenda dy javësh pas pranimit të raportit.
5. Grupi i ekspertëve mund ta korrigjojë raportin e vlerësimit në bazë të komenteve të paraqitura nga institucioni dhe duhet të dorëzojë raportin final në AKA, jo më vonë se tetë javë pas vizitës në institucion.

## **Neni 15**

### **Përgatitja e vendimit të akreditimit**

1. Drejtori i AKA-së harton një raport përmbledhës (Rezyme) në bazë të raportit të ekipit vlerësues të cilin ia përcjellë Këshillit Kombëtar të Cilësisë.
2. Në bazë të rekomandimeve nga raporti i ekspertëve, KKC merr vendim për akreditim.
3. Këshilli Kombëtar i Cilësisë i merr vendimet me shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të tij.
4. Vendimet e Këshillit Kombëtar të Cilësisë që kanë të bëjnë me akreditim të një IAL ose shqyrtimin e akreditimit janë të plotfuqishme vetëm nëse në mbledhje është i pranishëm të paktën njëri nga anëtarët ndërkombëtar të KKC .
5. Institucionit aplikues i komunikohet vendimi për akreditim nëpërmjet një njoftimi me shkrim. Njoftimi duhet të përmbajë informacionet në vazhdim:
  - 5.1 emërtimin e institucionit;
  - 5.2 vendndodhjen (adresën) e institucionit (kampusit);
  - 5.3 emërtimin, llojin dhe kohëzgjatjen e studimeve që ofrohen në institucion;
  - 5.4 titujt/thirrjet e Diplomave profesionale dhe certifikatave që mund të fitohen në institucion;
  - 5.5 kohëzgjatjen e akreditimit.
6. Në rast të akreditimit të programeve të studimit në njoftim precizohet qartë se cilat programe janë akredituar.
7. Vendimi i KKC për akreditim duhet të miratohet nga Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë para njoftimit të institucionit përkatës.
8. Institucioni ka të drejtë ta tërheqë aplikacionin për akreditim para dorëzimit të raportit final të vlerësimit nga grupi i ekspertëve.
9. Në rast të tërheqjes së kërkesës për akreditim, institucioni ka të drejtë të aplikojë përsëri pas një viti.
10. Nëse një institucion nuk arrin të marrë akreditimin apo riakreditimin, ai mund të përsëris kërkesën jo më vonë se pas një viti.
11. Nëse institucioni dështon për herë të dytë në marrjen e akreditimit, atëherë të njëjtit i merret licenca.

## **Neni 16**

### **Shpenzimet e procesit të akreditimit**

1. Institucioni privat do të bartë shpenzimet e bëra gjatë procesit të vetëvlerësimit.
2. Shpenzimeve për procesin e akreditimit të institucioneve publike mbulohen nga MASHT.

3. Shpenzimet për procesin e akreditimit të institucioneve private të arsimit të lartë, duke përfshirë të gjitha shpenzimet për ekipe të ekspertëve, mbulohet nga ana e institucionit që aplikon për akreditimin. AAK bën llogaritjen paraprake për shpenzimet e procesit të akreditimit dhe e njofton me kohë institucionin.
4. Shpenzimet për shqyrtimin e aplikacionit për akreditim dhe dokumentacionit përcjellës janë:
  - 4.1. akreditimi ex-ante i institucionit.....3000 (tremijë) Euro
  - 4.2. akreditimi i një programi të ri të studimeve.....1000 (njëmijë) Euro
  - 4.3. riakreditimi institucional.....2000 (dymijë) Euro
  - 4.4. riakreditimi i një programi të studimeve.....500 (pesëqind) Euro.
5. Institucionet private me dorëzimin e aplikacionit për akreditim janë të obliguara që të dorëzojnë edhe dëshminë mbi pagesën e shpenzimeve të procesit.
6. Shpenzimet e një ekipi vlerësues llogariten duke shumëzuar shumën 3300 Euro (tremijë e treqind), (shpenzimet e llogaritura për një ekspert ndërkombëtar në ekipin e vlerësimit) me numrin e ekspertëve në ekip.
7. Në rast se një institucion i arsimit të lartë privat e tërheq aplikacionin para vizitës së grupit të ekspertëve të jashtëm, atij do t'i kthehen 50% të mjeteve të paguara në llogari të shpenzimeve të procesit.
8. Institucionet private të akredituara do t'i paguajnë AKA çdo vit shumën 5 (pesë) Euro për një student në emër të taksave për akreditim (MASHT).

### **Neni 17 Certifikata e akreditimit**

1. Certifikata e akreditimit lëshohet nga Agjencia Kosovare e Akreditimit.
2. Vendimi për akreditim hyn në fuqi nga data e caktuar nga Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë të Kosovës. Kjo zakonisht do të bëhet brenda një muaji nga marrja e vendimit të Këshillit Kombëtar të Cilësisë. Kjo datë do të jetë datë efektive për periudhën e specifikuar të akreditimit në Certifikatën e akreditimit.
3. Në rast se rekomandimet e AKA nuk përkojnë me gjendjen objektive të ndonjë bartësi të arsimit të lartë ose KKC jep rekomandime që bien ndesh me raportin e vlerësimit të jashtëm, Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë ka të drejtë të formojë një panel ndërkombëtar për miratimin/mosmiratimin e vendimit për akreditim.

### **Neni 18 Publikimi i rezultateve të akreditimit**

1. Të gjitha palët e përfshira gjatë procesit të akreditimit duhet t'i trajtojnë rezultatet e vlerësimit në mënyrë të besueshme.
2. AKA, në faqen e saj të internetit, publikon vendimin për akreditim dhe raportin e vlerësimit, vetëm pasi Ministri të ketë marrë vendimin e tij.

## **Neni 19**

### **Kohëzgjatja e akreditimit**

1. Kohëzgjatja e akreditimit është një vit në fazën e parë.
2. Institucionet e akredituara janë të obliguara që në fund të çdo viti kalendarik të dorëzojnë në AKA një raport vjetor gjithëpërfshirës për veprimtaritë e tyre, duke përfshirë edhe planin e përmirësimit (aktivitetet vijuese) bazuar në rekomandimet e raportit të ekspertëve.
3. Institucionet e akredituara janë të obliguara që të njoftojnë me kohë AKA për të gjitha ndryshimet e bëra, duke përfshirë:
  - 3.1. ndryshimin e pronësisë së institucionit;
  - 3.2. ndryshimin e emërimit të institucionit;
  - 3.3. ndryshimin e statutit të institucionit;
  - 3.4. ndryshimin e dukshëm të programeve ekzistuese të studimit;
  - 3.5. ndryshimet në kontratat me mësimdhënësit dhe personelin vlerësues;
  - 3.6. ndryshimin e lokacionit të institucionit;
  - 3.7. vështirësitë që hasen në përmbushjen e standardeve të cilësisë.
4. Nëse aplikimi për riakreditimin nuk do të paraqitet në kohën e duhur (jo më vonë se një vit para skadimit të periudhës aktuale të akreditimit), akreditimi aktual do të pushojë menjëherë.

## **Neni 20**

### **Revokimi/tërheqja e akreditimit**


1. AKA ruan të drejtën për të inspektuar institucionet e akredituara në çdo kohë, me ose pa paralajmërim.
2. AKA mund të rishqyrtojë akreditimin e dhënë në çdo kohë dhe si rezultat i kësaj mund të tërheqë vendimin për akreditim.
3. AKA mund ta tërheqë akreditimin nëse ka fakte se në një ose më shumë fusha të vlerësimit për të cilat është dhënë akreditimi ka rënie të theksuar të cilësisë.
4. Akreditimi mund të tërhiqet edhe në rastet kur konstatohet se aplikuesi ka ofruar informacione dhe dokumente të rrejshme të cilat kanë ndikuar në dhënien e akreditimit.

**Neni 21**  
**E drejta për ankesë**

1. Përveç nëse specifikohet ndryshe nga LAL, në qoftë se një institucion nuk është i kënaqur me vendimet e marra nga AKA, ai ka të drejtë të bëjë ankesë në AKA, MASHT ose në gjykatën kompetente.

**Neni 22**  
**Hyrja në fuqi**

- 1 Ky Udhëzim administrativ hyn në fuqi pas nënshkrimit nga ministri.



Enver Hoxhaj, ministër